

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 3802 / Prot
6

Datë 02.12.2025

VENDIM

Nr. 137, datë 27.11.2025

**“PËR DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK
Znj.Erjona Ibrahim Jaurri**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 49 pika 1, neni 50, Këshilli i Bashkisë Tiranë, mbështetur në raportin e Komisionit të Vërtetimit të Mandateve, në mbledhjen e Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan kandidatit në listën shumemërore të Partisë “Bashkë Fitojmë” Znj.Erjona Ibrahim Jaurri
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
KËSHILLIT BASHKIAK
LUTFI LALA**



3802/7
11.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1274/1 Prot.

Elbasan më 11.12 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.137, datë 27.11.2025 “Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak” Znj. Erjona Ibrahim Jaurri, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 5849/11 Prot

Elbasan më 02 / 12 / 2025

VENDIM

Nr 138 datë 27 / 11 / 2025.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin TETOR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin TETOR 2025, 105 familje me fond 296.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



Miratuar datë _____

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

5843/2

03.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 12751 Prot

Elbasan, më 03.12.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.138 datë 27.11.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Tetor 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir Bejtja





1276

02.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 5850 / Prot
1

Elbasan më 02 / 12 / 2025

VENDIM

Nr. 139 datë 27 / 11 / 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin TETOR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **TETOR 2025** gjithsej 266 familje me një fond prej 1.261.284 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kryetar I Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



Miratuar datë _____

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

5850/2
03.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1276/1 Prot

Elbasan, më 03.12.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.139 datë 27.11.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5928/1 Prot.

Datë 02 .12. 2025

VENDIM

NR. 142 DATË 27 . 11. 2025

MBI

“Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH-në, për vitin 2025”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .11.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH-në, për vitin 2025”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, shkresën e Ministrisë së Financave, nr.14505/11, datë 24.10.2025, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.138, datë 26.12.2024, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, i ndryshuar,

VENDOSI

1. Detajimin e shtesës së fondeve nga transfertat sektoriale për SHMZSH-në, për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025, si më poshtë :

Funksioni	njësia shpenz.	shtesë fondi/lekë	art.606(shpërblim)	art.231(investim)
Shërbimi MZSH	AMK	2,883,000	2,667,200	215,800

Artikulli 231 : “Blerje Kit sharrë elektrike me bateri (troko) dhe grepa zjarri dinamik me 4 pjesë”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë dhe AMK.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli

Dr.Buxhet Finance : A.Merkja

D.P.SH.M: S. Mehmeti

Dr.Juridike: A. Hoxha

KRYETARI

Lutfi Lala



5328/2
4.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1279/11 Prot

Elbasan, më 4.12.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.142, datë 27.11.2025 “Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH-në, për vitin 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5973 Prot.

Elbasan më 02.12.2025

VENDIM

Nr. 143 Datë 27.11.2025

“Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës, së Z.Pren Mihal Bërdufi banorë në Fshatin Stërstan, Njësia Administrative Gjinar, përcaktuar në VKB Nr. 172 datë 04.12.2019 të Bashkisë Elbasan”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 172 datë 04.12.2019 Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës, së Z.Pren Mihal Bërdufi banorë në Fshatin Stërstan, Njësia Administrative Gjinar, Shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nr.1875/3 datë 23.10.2025 “ Mbi Kërkesën për konfirmim mbi likuidimin e banoreve të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore “, si edhe pasi shqyrtoi relacionin e pararaqitur nga administrata e Bashkisë, dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 172 datë 04.12.2019 “Për miratimin e ndihmës financiare, për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja në banesën e familjes të **Z. Pren Mihal Bërdufi**, fshatit Stërstan, Njësia Administrative Gjinar”; bëhen këto korigjime:
 - Në pikën 1, vlera totale e dëmeve **ishte** $1,900,716 \times 50 \% = 950,358$ lekë, duhet të **bëhet** $1,800,536 \times 50\% = 900,268$ lekë (nëntëqind mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndertimore në banesë të hartuar nga ekspertet perkates.
2. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.64 datë 30.05.2025 “Për miratimin e fondit të kushtezuar të mbrojtjes civile për vitin 2025 “ i ndryshuar.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala



<u>Konceptoi:</u>	Specialist	A..Baku
<u>Pranoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
	Dr. Fin dhe Buxhet	A. Merkja
<u>Miratoi:</u>	Dr. PPMCMBPk	Sh.Çullhaj
	Dr. Juridike	A.Hoxha
<u>Konfirmoi:</u>	Zv/ Kryetari	A. Sula

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kunder _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur me datë ____ / ____ 2025

5973/2

14.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 1280/1 Prot.

Elbasan, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Br.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 143 datë 27.11.2025 "Për korigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës, të Z.Pren Mihal Bërdufi, banor në fshatin Stërstan, Njësia Administrative Gjinar, përcaktuar në Vendimin nr.172 datë 04.12.2019 të Këshillit të Bashkisë Elbasan (në shumën 900.268 lekë)", burimi i financimit nga fondi i Mbrojtjes Civile i bashkisë i miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.64 datë 30.05.2025, "Për miratimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025 i ndryshuar", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV (I RISHIKUAR NENDOR 2025)

Emërtimi: Banesë e dëmtuar nga rrëshqitja në Fshatin Sterstan, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan
Pronari i objektit: Z.Pren Mihal Bërdufi
Vendodhja e banesës : Fshati Sterstan, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan
Sipërfaqja totale e ndërtesës: 104.65 m²
Sipërfaqja e dëmtuar e banesës : 104.65 m²
Vlera e përlogaritur : 1.800.536 lekë

Nr	Nr.analize	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		PUNIME NDERTIMI				
1	52/2	Mur guri me per themele e xokol II.M-25	m ³	45.045	5283	237,973
2	54/1	Mur guri lartesi+llac m-15	m ³	19.175	7034	134,877
3	64/2	Mur me tulla te zakonshme II.M-25	m ³	32.24	12305	396,713
4	264	Shtrese lluste çimento 1:2	m ²	94.00	337	31,678
5	310	Suvatim i brendshem muri tulle me llac te perzier	m ²	318.6	685	218,255
6	293	Tavan res kallami + suva	m ²	94	1911	179,634
7	219	Çati vendi h.d-8 m tjeg.mars pa lluster	m ²	138.24	2491	344,356
8	An	Dyer te brendeshme tamberurato te thjeshta/me dekor	m ²	8.6	9725	83,635
9	An	F.V.Vetrata druri me punime	m ²	11.4	7950	90,630

10	121/1	Breze beton/arme C16/20	m ³	3.2175	11749	37,802
12	399	Sherbetim me gëlqere pa pigment	m ²	412.62	48	19,806
		SHUMA I				1,775,359
II		PUNIME HIDRAULIKE				
1		Tub PE 100 Pn 16 1/2 "- 2 "	ml	20		-
2		Tub plastik O 110	kg	22		-
3		Tub plastik O 50	kg	15		-
4		Tub plastik O 40	kg	15		-
5		Rakorderi	cope	34		-
6		WC allafanga	cope	1		-
7	494	F.V.sarcineske bronxi 1/2"	cope	1	876	876
		SHUMA II	leke			876
III		PUNIME ELEKTRIKE				
1	481/3	F.V. Percjellesa P.V. - 500 4 mm ²	ml	15	94	1,410
2	481/2	F.V. Percjellesa P.V. - 500 2.5 mm ²	ml	45	71	3,195
3	481/1	F.V. Percjellesa P.V. - 500 1.5 mm ²	ml	15	48	720
4	480	F.V. tuba plasmasi Φ14-17 mm	ml	60	96	5,760
5	480/2	F.V. tuba plasmasi Φ22-26 mm	ml	15	134	2,010
6	An	Kuti shperndarese plastike PT6	cope	5	254	1,270
7	486	F.V. portollampa	cope	8	217	1,736
8	483	F.V.celsa te zakonshem brenda murit	cope	20	410	8,200

9	Siguresa-25 A	cope	2		-
		SHUMA III	leke		24,301
		SHUMAI+II+III			1,800,536

Ky preventiv është llogaritur me çmimet në fuqi miratuar nga Këshilli I Ministrave për Entin Kombëtar të banesave bazuar pikës III/3/b, të VKM- së nr.329, datë 16.05.2012" Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkatuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkatuara nga veprimtaria njerëzore"

Rivleresimi është bërë sipas urdherit Nr.985 dt 14/11/2025 dhe proces - verbalit të mbajtur me datë 26.06.2017.

Komisioni

Ing. Arjan Baku

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybell

Administratë e

Emmanuel



Drejtori i Mbrojtjes Civile

Ndriçim Sinani

(Handwritten signature)

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

Gledian Llatja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5972 Prot.

Elbasan më 02.12.2025

VENDIM

Nr. 144 Datë 27 . 11.2025

**“Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së
Z.Myftar Ibrahim Dervishi banorë në Fshatit Xibrakë, Njësia Administrative
Labinot Fushë, përcaktuar në VKB Nr. 162 datë 27.11.2020 të Bashkisë Elbasan”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare,për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera,të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKB nr. Nr. 162 datë 27.11.2020 “Për korrigjimin e vleres financiare te dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës Z.Myftar Ibrahim Dervishi, fshatit Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë”, Shkresen e Agjencise Kombetare te Mbrojtjes nr.1875/3 date 23.10.2025 “Mbi Kerkesen per konfirmim mbi likuidimin e banoreve te demtuar nga fatkeqsi natyrore “, si edhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkise , dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 27.11.2020 “Për korrigjimin e vleres financiare te dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës **Z. Myftar Ibrahim Dervishi**, fshatit Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë”; bëhen këto korrigjime:
 - Në pikën 1,vlera totale e dëmeve **ishte** 293,675 x 50 % =146,837 lekë,duhet të **bëhet** 315,320 x 50 % =157,660 lekë (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë.
 - Në pikën 2,vlera e dëmit në pajisje dhe orendi shtëpiake **ishte** 57 000 lekë,duhet të ngelet e njëjtë **57 000** (pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë.
 - Në pikën 3 fondi për pikat 1 dhe 2 nga 203,837 lekë të **bëhet** 214,660 (dyqind e katërmbëdhjetë mijë gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë. Kjo vlere është rezultat 50% te vleres se preventivit te dëmeve ndertimore ne banese te hartuar nga eksperte duke shtuar me pas vleren e preventit ne pajisje dhe orendi d.m.th, 315,320 x 50 % =157,660 + 57.000 = 214.660 leke.

2. Burimi i financimit do te jete Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar ne buxhetin e Bashkise Elbasan per vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.64 date 30.05.2025 “ Per miratimin e fondit te kushtezuar te mbrojtjes civile per vitin 2025 “ i ndryshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala



<u>Konceptoi:</u>	Specialist	A..Baku
<u>Pranoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
	Dr. Fin dhe Buxhet	A. Merkja
<u>Miratoi:</u>	Dr. PPMCMCBPK	Sh.Çullhaj
	Dr. Juridike	A.Hoxha
<u>Konfirmoi:</u>	Zv/ Kryetari	A. Sula

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kunder _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur me datë ____/____ 2025

5872/2
11.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 1281/ Prot.

Elbasan, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Br.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 144 datë 27.11.2025 "Për korigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Myftar Ibrahim Dervishi, banor në fshatin Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë, përcaktuar në Vendimin nr.162 datë 27.11.2020 të Këshillit të Bashkisë Elbasan (në shumën 214.660 lekë)", burimi i financimit nga fondi i Mbrojtjes Civile i bashkisë i miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.64 datë 30.05.2025, "Për miratimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025 i ndryshuar", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV (I RISHIKUAR NENDOR 2025)

Emërtimi: Banesë e djezur në Fshatin Xibrake, Njësia Administrative Labinot Fushë, Bashkia Elbasan
Pronari i objektit: Z.Myftar Ibrahim Dervishi
Vendodhja e banesës : Fshati Xibrake, Njësia Administrative Labinot Fushë, Bashkia Elbasan
Sipërfaqja totale e ndërtesës 2- kateshe : 74.25 m²
Sipërfaqja e djezur e banesës : 49.5 m²
Vlera e përlogaritur : 315.320 lekë

Nr	Nr.analize	Përshkrimi i punimeve	njesia	sasia	çmimi	vlera
I		PUNIME NDERTIMI				
1	293	Tavan res kallami+suva	m ²	16.8	1911	32,105
	279	Shtrese me derrase dysheme 2.5 cm+listela	m ²	16.8	1575	26,460
2	219	Çati vendi h.d-8m,tieg,mars pa lluster	m ²	43.2	2491	107,561
3	An	Dyer te brendshme tamburato te thjeshta/me dekor	m ²	4.3	9725	41,818
4	An	F.v. Vetrata druri,me punime	m ²	2.04	7950	16,218
5	121/1	Brez beton/arme C 16 / 20	m ³	2.6	11749	30,547
6	310	Suvatim i brendshem mur guri me llaç i perzier	m ²	30	685	20,550
7	264	Shtrese lluste çimento 1:2	m ²	16.8	337	5,662
8	399	Sherbeim me gëlqere pa pigment	m ²	199.92	48	9,596
		SHUMAI				290,517

PUNIME ELEKTRIKE						
III						
1	481/3	F.V. Percjellesa P.V. - 500 4 mm ²	ml	25	94	2,350
2	481/2	F.V. Percjellesa P.V. - 500 2.5 mm ²	ml	60	71	4,260
3	481/1	F.V. Percjellesa P.V. - 500 1.5 mm ²	ml	30	48	1,440
4	480	F.V. tuba plasmasi Φ14-17 mm	ml	90	96	8,640
5	480/2	F.V. tuba plasmasi Φ22-26 mm	ml	25	134	3,350
6	487	Kuti plastike celesa dhe priza	cope	3	102	306
7	483	F.V. celsa te zakonshem brenda murit	cope	3	410	1,230
8	486	F.V. portollampa	cope	3	217	651
9	An	Kuti shperndarese plastike PT2	cope	3	196	588
10	485	F.V. priza me nulifikim	cope	4	497	1,988
		SHUMA II				24,803
		SHUMA I+II				315,320

Ky preventiv është llogaritur me çmimet në fuqi miratuar nga Këshilli I Ministrave për Entin Kombëtar të banesave bazuar pikës III/3/b, të VKM- së nr.329, datë 16.05.2012" Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkatuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

Rivleresimi është bere sipas urdherit Nr.985 dt 14/11/2025 dhe proces - verbalit te mbajtur me date 20.07.2015

Komisioni

Ing. Arjan Baku

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybeli

Adm. strator, A.A. L. Fushë



Drejtori i Mbrojtjes Civile

Ndriçim Sinani

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE

Gledian Matija





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV (I RISHIKUAR NENDOR 2025)

Emërtimi: Banesë e djezur në Fshatin Xibrake, Njësia Administrative Labinot Fushe, Bashkia Elbasan
Pronari i objektit: Z.Myftar Ibrahim Dervishi
Vendodhja e banesës : Fshati Xibrake, Njësia Administrative Labinot Fushe, Bashkia Elbasan
Sipërfaqja totale e ndërtesës 2- kateshe : 74.25 m²
Sipërfaqja e djezur e banesës : 49.5 m²
Vlera e përlogaritur : 57.000 lekë

Nr	Nr.analize	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		PAJISJE+ORENDI SHTEPIAKE				
1	1	Sobe elektrike	cope	1	22000	22,000
2	3	Frigorifer	cope	1	22000	22,000
3		Tapet	cope	1		-

5	15	Kudra Bufe (Bufë Guzhine)	cope	1	13000	13,000
			SHUMA I			57,000

Ky preventiv është llogaritur llogaritur sipas Shkreses Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Nr. 1806/1 date 29.02.2016 se bashku me dokumentacionin plotësuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329 dt.16. 05. 2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtari njerëzore ”

Rivleresimi është bere sipas urdherit Nr.985 dt 14/11/2025 dhe proces - verbalit te mbajtur me date 20.07.2015

Komisioni

Ing. Arjan Baku

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybell

Administratori i N. Adm. L. Fushë



Drejtori i Mbrojtjes Civile

Ndriçim Sinani

[Signature]

MIRATOHET

KRYETARI BASHKISE

Gledian Latifa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5970 Prot.

Elbasan më 02.12.2025

VENDIM

Nr. 145 Datë 27.11.2025

“Për korrigjimin e ndihmës financiare, dhe miratimin e vleresimit të dëmeve nga ana ndertimore dhe dëmeve ne orendi , mobilje dhe pajisje elektro -shtëpiake , te shkaktuara nga zjarri ne familjen e Z. Hysen Sali Pisha banore në Fshatin Bene, Njësia Administrative Labinot Mal, përcaktuar në VKB Nr. 30 datë 20.02.2018 të Bashkisë Elbasan”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare,për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera,të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKB nr. 30 datë 20.02.2018 “ Për miratimin e ndihmës financiare, dhe miratimin e vleresimit të dëmeve nga ana ndertimore dhe dëmeve ne orendi , mobilje dhe pajisje elektro -shtëpiake , te shkaktuara nga zjarri ne familjen e **Z. Hysen Sali Pisha**, fshatit Bene, Njësia Administrative Labinot Mal ”, Shkresen e Agjencise Kombetare te Mbrojtjes nr.1875/3 date 23.10.2025 “ Mbi Kerkesen per konfirmim mbi likuidimin e banoreve te demtuar nga fatkeqsi natyrore “, si edhe pasi shqyrtoi relacionin e pararaqitur nga administrata e Bashkise , dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 30 datë 20.02.2018 “ Për miratimin e ndihmës financiare, dhe miratimin e vleresimit të dëmeve nga ana ndertimore dhe dëmeve ne orendi , mobilje dhe pajisje elektro -shtëpiake , te shkaktuara nga zjarri ne familjen e **Z. Hysen Sali Pisha**, fshatit Bene, Njësia Administrative Labinot Mal ”, ; bëhen këto korigjime:

- Në pikën 1,vlera totale e dëmeve **ishte** 1,139 ,978 x 50 % = 569 ,989 lekë, duhet të **bëhet** 1,142,597 x 50 % = 571.298 lekë (pesëqind e shtatedhjetë e nje mijë e dyqinde e nentedhjetë e tete) lekë.
- Në pikën 2,vlera e dëmit në pajisje dhe orendi shtëpiake **ishte 229 000 lekë**,duhet të **bëhet** 248 000 (dyqind e dyzetë e tetë mijë) lekë.
- Në pikën 4 fondi për pikat 1 dhe 3 nga 684.489 lekë të **bëhet 819,298** (tetëqind e nentëmbëdhjetë mije e dyqinde e nentedhjetë e tete) lekë. Kjo vlere është rezultat 50% te vleres se preventivit te dëmeve ndertimore ne banese te hartuar nga eksperte duke shtuar me pas vleren e preventit ne

pajisje dhe orendi d.m.th, $1,142,597 \times 50 \% = 571.298 + 229.000 = 819.298$
leke.

2. Burimi i financimit do te jete Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar ne buxhetin e Bashkise Elbasan per vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.64 date 30.05.2025 “ Per miratimin e fondit te kushtezuar te mbrojtjes civile per vitin 2025 “ i ndryshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	A.Baku
<u>Pranoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
	Dr. Fin dhe Buxhet	A. Merkja
<u>Miratoi:</u>	Dr. PPMCMBPK	Sh.Çullhaj
	Dr. Juridike	A.Hoxha
<u>Konfirmoi:</u>	Zv/ Kryetari	A. Sula

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kunder _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2025

5970/2
11.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 1282/1 Prot.

Elbasan, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Br.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.145 datë 27.11.2025 "Për korrigjimin e ndihmës financiare dhe miratimin e vlerësimit të dëmeve nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orendi, mobilje e pajisje elektro-shtëpiake, të shkaktuar nga zjarri në familjen e Z.Hysen Sali Pisha, banor në fshatin Benë, Njësia Administrative Labinot Mal, përcaktuar në Vendimin nr.30 datë 20.02.2018 të Këshillit të, Elbasan (në shumën 819.298 lekë)", burimi i financimit nga fondi i Mbrojtjes Civile i bashkisë i miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.64 datë 30.05.2025, "Për miratimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025 i ndryshuar", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

PREVENTIV (I RISHIKUAR NENDOR 2025)

Emërtimi: Banesë e dëgjur në Fshatin Bene, Njësia Administrative Labinot Mal, Bashkia Elbasan
Pronari i objektit: z. Hysen Sali Pisha
Vendodhja e banesës : Fshati Bene , Njësia Administrative Labinot Mal, Bashkia Elbasan
Sipërfaqja totale e ndërtesës 2- kateshe: 126.48 m²
Sipërfaqja e dëgjur e banesës : 126.48 m²
Vlera e përllogaritur : 1.142.597 lekë

Nr	Nr.analize	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		PUNIME NDERTIMI				
1	218	Çati vendi h.d-8m,tjegull vendi	m ²	126.5	3761	475,691
2	399	Sherbetim me gëlqere pa pigment	m ²	402.7	48	19,330
3	54/1	Mur guri ne lartesi+ llac m-15	m ³	2.3	7034	16,178
4	279	Shtrese me derrase dyshe me 2.5 cm+ listela	m ²	91.7	1575	144,428
5	293	Tavan les kallami + suva	m ²	91.7	1911	175,200
6	An	Dyer te brendshme tamburato te thjeshta	m ²	17.40	9725	169,215
7	An	F.V. Vetrata druri me punime	m ²	14.4	7950	114,480

8	310	Suvatim i brendshem mur guri me llaç i perzier	m ²	35	685	23,975
		SHUMA I				1,138,497
II		PUNIME ELEKTRIKE				
1	483	F.V. celesa te zakonshem brenda murit	cope	10	410	4,100
		SHUMA II				4,100
		SHUMA I+II				1,142,597

Ky preventiv është llogaritur me çmimet në fuqi miratuar nga Këshilli I Ministrave për Entin Kombëtar të banesave bazuar pikës III/3/b, të VKM-së nr.329 datë 16.05.2012" Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

Rivleresimi eshte bere sipas urdherit Nr.985 dt 14/11/2025 dhe proces - verbalit te mbajtur me date 17.03.2017

Komisioni

Ing. Arjan Baku

Ark. Klajdi Haxhihyse

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybelli

N.H. Mol

Yliber Kuc



Drejtori i Mbrojtjes Civile


Ndriçim Sinani

[Signature]

MIRATOHET

KRYETARI BASHKISE

Gledian Llatja





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV (I RISHIKUAR NENDOR 2025)

Emërtimi: Banesë e djezur në Fshatin Bene, Njësia Administrative Labinot Mal, Bashkia Elbasan

Pronari i objektit: z. Hysen Sali Pisha

Vendodhja e banesës :Fshatin Bene , Njësia Administrative Labinot Mal, Bashkia Elbasan

Sipërfaqja totale e ndërtesës 2- kateshe: 126.48 m2

Sipërfaqja e djezur e banesës : 126.48 m2

Vlera e përllogaritur : 248.000 lekë

Nr	Nr.analize	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		PAJISJE+ORENDI SHTEPIAKE				
1	4	Televizor	cope	1	25000	25,000
2	3	Frigorifer	cope	1	22000	22,000
3	14	Divane	cope	2	8000	16,000
4	9	Dhome gjumi (krevat dopio+dyshek)	cope	2	85000	170,000
5	15	Kudra Bufe (Bufe Guzhine)	cope	1	6000	6,000

6	Dyshek	cope	4		-
7	Jorgane	cope	8		-
8	Komplet Guzhhine	cope	1		-
9	Tavoline Buke	cope	1	5000	5,000
10	Karrige te zakonshme	cope	4	1000	4,000
SHUMA I					248,000

Ky preventiv eshte llogaritur llogaritur sipas Shkreses Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve me Nr. 1806/1 date 29.02.2016 se bashku me dokumentacionin e plotesuar sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.329 dt.16. 05. 2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shaktuara nga veprimtari njerezore "

Rivleresimi eshte bere sipas urdherit Nr.985 dt 14/11/2025 dhe proces - verbalit te mbajtur me date 17.03.2017

Komisioni

Ing. Arjan Baku

Ark. Klajdi Haxhinyzeni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybe

[Signature]

Nj. Adm. L. Mbi

Y/bex Kuci



Drejtori i Mbrojtjes Civile

Ndricim Sinani

[Signature]

MIRATOHEFT

KRYETARI I BASHKISE

Gledian Latifa

[Signature]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5971 Prot.

Elbasan më 02 . 12 .2025

VENDIM

Nr. 146 Datë 27 . 11 .2025

“Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës, së Z.Hasan Xhevit Muzhaqi banorë në Fshatin Polis i Vogel, Njësia Administrative Shushicë, përcaktuar në Vendimin Nr. 84 datë 12.06.2015 të Keshillit të Komunes Shushice, Elbasan.”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Vendimin e Këshillit Komunes Shushice Elbasan nr. 84 datë 12.06.2015 “ Mbeshtetje financiare nga ana e shtetit për demtimin e shtepive të banimit nga rreshqitja e tokës” ku përfshihet dhe banesa familjes të **Z. Hasan Xhevit Muzhaqi**, fshatit Polis i Vogel, Njësia Administrative Shushicë”, Shkresen e Agjencise Kombetare të Mbrojtjes nr.1875/3 date 23.10.2025 “ Mbi Kërkesen për konfirmim mbi likuidimin e banoreve të demtuar nga fatkeqsi natyrore “, si edhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkise , dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

V E N D O S I :

1. Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e tokës në banesën e familjes të **Z. Hasan Xhevit Muzhaqi**, fshatit Polis i Vogel, Njësia Administrative Shushicë” të miratuara me vendimin e Këshillit të Komunes Shushice Nr. 84 datë 12.06.2015 “ Mbeshtetje financiare nga ana e shtetit për demtimin e shtepive të banimit nga rreshqitja e tokës “ ; të bëhen këto korigjime:

- Në pikën 1, vlera totale e dëmeve ishte 4,440,886 x 50 % =2,220,443 lekë, duhet të bëhet 2,921,431 x 50 % =1,460,715 lekë (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimore në banesë të hartuar nga ekspertet përkatëse.

2. Burimi i financimit do të jete Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar ne buxhetin e Bashkise Elbasan per vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.64 date 30.05.2025 “ Per miratimin e fondit te kushtezuar te mbrojtjes civile per vitin 2025 “ i ndryshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	A.Baku
<u>Pranoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
	Dr. Fin dhe Buxhet	A. Merkja
<u>Miratoi:</u>	Dr. PPMCMGBK	Sh.Çullhaj
	Dr. Juridike	A.Hoxha
<u>Konfirmoi:</u>	Zv/ Kryetari	A. Sula



Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kunder _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2025

5971/2

11.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 12831 Prot.

Elbasan, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjia "Br.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.146 datë 27.11.2025 "Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës së Z.Hasan Xhevit Muzhaqi, banor në fshatin Polis i Vogël, Njësia Administrative Shushicë, përcaktuar në Vendimin nr.84 datë 12.06.2015 të Këshillit të Komunës Shushicë, Elbasan (në shumën 1.460.715 lekë)", burimi i financimit nga fondi i Mbrojtjes Civile i bashkisë i miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.64 datë 30.05.2025, "Për miratimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025 i ndryshuar", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV (I RISHIKUAR NENDOR 2025)

Emërtimi: Banesë e dëmtuar nga rrëshqitjet në Fshatin Polis i Vogel, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan
Pronari i objektit: Z. Hasan Xhevit Muzhaqi
Vendodhja e banesës :Fshati Polis i Vogel, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan
Sipërfaqja totale e ndërtësës 2- kateshe :227.63 m2
Sipërfaqja e demtuar e banesës 2- kateshe :227.63 m2
Vlera e përlogaritur : 2.921.431 lekë

Nr	Nr.analize	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		PUNIME NDERTIMI				
1	52/2	Mur guri per themele e xokul-II.M-25	m ³	56.38	5283	297,856
2	54/1	Mur guri ne lartesi+llac m-15	m ³	132.7	7034	933,412
3	86	Mur tullle 8 vrima t=12 cm II.M-15	m ³	1.512	8986	13,587
4	293	Tavan res kallami+suva	m ²	154.38	1911	295,020
5	220/1	Cati me llamarina h.d deri 8 m	m ²	9.4	2207	20,746
6	218	Cati vendi h.d-8 m tjegull vendi	m ²	102.34	3761	384,901
7	An	Dyer te brendshme tamburato te thjeshta/me dekor	m ²	11.7	9725	114,172
8	An	F.v. Vetrata druri,me punime	m ²	10.89	7950	86,576

9	121/1	Brez beton/arme C 16 / 20	m ³	11.2	11749	131,589
10	310	Suvatim i brendshem mur guri me llaç i perzier	m ²	235.59	685	161,379
11	279	Shtrese me derrase dysheme 2.5 cm+listela	m ²	73.02	1575	115,007
12	264	Shtrese lluste cimento 1:2	m ²	95.77	337	32,274
13	334	Suvatim i jashtem i zakonshem mur guri	m ²	235.98	984	232,204
14	399	Sherbeum me gelqere pa pigment	m ²	471.57	48	22,635
						2,841,357
SHUMA I						
II						
PUNIME HIDRAULIKE						
1		Tub PE 100 Pn 16 1/2 "- 2 "	ml	20		
2		Tub plastik Ø 110	kg	22		
3		Tub plastik Ø 50	kg	15		
4		Tub plastikn Ø 40	kg	15		
5		Rakorderi	cope	34		
6	495	F.V.lavaman cilesi e II+grup	cope	2	7993	15,986
7		F.V. VC allafranga	cope	2		
						15,986
SHUMA II						
III						
PUNIME ELEKTRIKE						
1	481/3	F.V. Percjellesa P.V. - 500 4 mm ²	ml	50	94	4,700
2	481/2	F.V. Percjellesa P.V. - 500 2.5 mm ²	ml	140	71	9,940
3	481/1	F.V. Percjellesa P.V. - 500 1.5 mm ²	ml	60	48	2,880
4	480	F.V. tuba plasmasi Ø14-17 mm	ml	200	96	19,200
5	480/2	F.V. tuba plasmasi Ø22-26 mm	ml	50	134	6,700
6	487	Kuti plastike celesa dhe priza	cope	25	102	2,550
7	486	F.V. portollampa	cope	8	217	1,736

[illegible]

Kivieresimi eshte bere sipas urdherit N.r.985 dt 14/11/2025 dhe proces - verbalit te mbajtur me date 16.02.2015 dhe date 14.02.2015

Komisioni

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybeli

Dreitori i Mbrojtjes Civile

Ndriçim Sinani

MIRATOHEIT

KRYETARI I BASHKISE

Gledian Ilatja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5974 Prot.

Elbasan më 02. 12. 2025

VENDIM

Nr. 147 Datë 07. 11. 2025

**"PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE MJEDISORE DHE VIZUALE PËR LICENCIMIN E
MJETEVE TAKSI (4+1) NË BASHKINË ELBASAN"**

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
 - Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar;
 - Vendimit nr. 325, datë 19.03.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor...", i ndryshuar;
 - Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar;
 - Udhëzimit nr. 1649, datë 16.08.1999 "Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", i ndryshuar;
 - Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - Udhëzimit nr. 12, datë 19.07.2007 "Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e licencave...", i ndryshuar;
 - Udhëzimit të përbashkët MPPTT-MF nr. 2348, datë 23.04.2008 dhe nr. 1726/1, datë 21.04.2008 "Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi";
 - Udhëzimit nr. 532, datë 07.02.2005 "Mbi mënyrën e operimit në shërbimin taksi", i ndryshuar;
- dhe mbështetur në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit, Sektori Licencimeve të Transportit,
Në mbledhjen e tij të datës _____.____.2025:

V E N D O S I:

Neni 1 – Licencimi i operatorëve të rinj

Nga 1 janari 2026 licencat për operatorët e rinj të taksive (4+1) jepen vetëm për mjetet **"Green"**:

- EV (Electric Vehicle);
- FCEV (Fuel Cell Electric Vehicle);
- PHEV me autonomi elektrike të regjistruar mbi 40 km.
- nuk janë më të vjetra se 5 vite nga viti i prodhimit.

Neni 2 - Ri licencimi i mjeteve ekzistuese

Mjetet ekzistuese, jo-Green, mund të ri licencohen deri më 1 janar 2030 vetëm nëse:

- janë Euro 5, OSE
 - nuk janë më të vjetra se 15 vite nga viti i prodhimit.
- Pas 1 janarit 2030 nuk lejohet ri licencimi i mjeteve jo-Green.

Neni 3 - Ngjyra dhe identiteti vizual

- Mjetet Green: ngjyrë e bardhë + logo Bashkia Elbasan + kuadrate jeshile.
- Mjetet ICE/HEV: ngjyrë e verdhë + logo sipas standardit ekzistues.
- Vendosja e tarifave të shërbimit taksi në vende të dukshme sipas legjislacionit në fuqi

Neni 4 – Zbatimi

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit - Sektori Licencimeve të Transportit për zbatimin e këtij vendimi dhe informimin e operatorëve të transportit dhe publikut për tarifat e reja.

Neni 5 – Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan.

S. K. Bashkiak:


Konceptoi: Për sek. Transp. K.Çekrezi

Drejt. A.Canaj

D.Juridike: A.Hoxha

KRYETARI

Lutfi Lala



5874/2

04.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1284/1 prot.

Elbasan, më 4.12.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.147 datë 27.11.2025 “Për miratimin e kritereve mjedisore dhe vizuale për licencimin e mjeteve taksi (4+1) në Bashkinë Elbasan”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5968 Prot.
2

Elbasan, më 02.12.2025

VENDIM

Nr. 148 datë 27.11.2025

“ Mbi transferimin e asetëve nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale dhe Bashkia Elbasan”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____.2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit “ **Mbi transferimin e asetëve nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale dhe Bashkia Elbasan**”, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) dhe në Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar);

V E N D O S I:

1. Të miratojë transferimin e asetëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes dhe Kontrollit tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale sipas përmbledhësës së inventarit fizik të mëposhtëm:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Viti i blerjes
1	Drona profesional	copë	1	293,400	293,400	14.06.2024
2	Kompjuter + Monitor 8 GB	copë	1	40,320	40,320	18.06.2024
3	Aparat dixhital profesional për matje në pyje (Vertex)	copë	1	347,400	347,400	26.06.2024
4	Kamera kurth (për pyje)	copë	2	51,600	103,200	12.09.2024

2. Të miratojë transferimin e asetëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes dhe Kontrollit tek Bashkia Elbasan sipas përmbledhësës së inventarit fizik të mëposhtëm:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Viti i blerjes
1	Kompjuter+Monitor 32 GB	copë	1	112,560	112,560	18.06.2024
2	Kompjuter+Monitor 16 GB	copë	2	76,800	153,600	18.06.2024
3	Aparat dixhital profesional për matje në pyje (Vertex)	copë	1	347,400	347,400	26.06.2024

4	Komplet perde e madhe	copë	5	16,000	80,000	24.07.2024
5	Komplet perde e vogël	copë	4	10,000	40,000	24.07.2024
6	Drona profesional	copë	1	293,400	293,400	14.06.2024
7	Vetrata alumini dhe xhama për ndarje zyrash	m ²	160	5,385	861,600	18.11.2024
8	Raft metalik (Arkive)	copë	5	19,300	96,500	29.12.2023

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Agjencia së Mbikëqyrjes dhe Kontrollit, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi LALA



Konceptoi :

Spec/Jurist: A.Xhika

Sp. Finance: D.Sulanjaku

Prgj. Sek. Finance: B.Lolja

Dr. i Përgjithshëm: K.Çullhaj

5968/3
04/12/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 12857 Prot

Elbasan, më 4.12.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.148, datë 27.11.2025 “Mbi transferimin e aseteve nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale dhe Bashkia Elbasan”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 5930/1 Prot.

Elbasan, më 02 . 12 . 2025

Vendim

Nr 143 Datë 27 / 11 /2025

Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, në lidhje me legalizimin e objekteve në zonat me përparësi zhvillimi, si dhe drefitn e paraqitur, bazuar në ligjin 139/2015 :Për vetqeverisjen vendore” nenet 8,9,10,30,54 të tij, VKM 435 datë 26.06.2024,

Vendosi

- 1- Të miratojë marrëveshjen midis Bashkisë Elbasan dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi
- 2- Ngarkohen Kryetari dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Dr. Legalizimeve
D.J.I.
Zv/Kryetar

A. Liçi
A. Hoxha
A. Sula

Kryetari
Lutfi Lala



5990/2

11.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1286/1 Prot.

Elbasan më 11.12. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.149, datë 27.11.2025 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 6064 Prot

Elbasan më 02.12.2025

VENDIM

Nr. 150 Datë 27.11.2025

Mbi miratimin e planit të aktiviteteve, konsultimeve publike dhe buxhetit të Këshillit
Bashkiak për vitin 2026

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .11. 2025, në mbështetje të ligjit Nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”:

VENDOSI

1. Të miratojë planin e aktiviteteve, konsultimeve publike dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2026 sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Bashkiak, Sekretari i Këshillit Bashkiak, Kryetari dhe Administrata e bashkisë me njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc. S.Gjorga

KRYETARI I KËSHILLIT
BASHKIAK

Lutfi Lala

6064/2

11.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 1287/prot.

Elbasan, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.150 datë 27.11.2025, "Miratimin e planit të aktiviteteve, konsultimeve publike dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA